



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.985/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit G... Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.58/20, të datës 01.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.02.2023, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.58/20, të datës 01.07.2021, vërtetohet.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.58/20, të datës 01.07.2021, nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit G... Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë si e bazuar, nën pikën II. anulohet aktvendimi me nr. 06.2/2016 i datës 10.12.2016 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, nën

pikën III. obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit G... Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, t'ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese, në vlerë prej 2,993.58€ (dymijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë e tetë cent) të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-61123/22.12.2016 në ZBD Prishtinë, si dhe t'ia paguaj kamatën vjetore prej 8% nga data e pagesës së detyrimeve doganore, datë 22.12.2016 e deri në pagesën definitive.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi A.nr. 58/20 e datës 01.07.2021 si e pa bazuar me ligj dhe të lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose ta kthej lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr. 06.2/09/2016 i datës 10.01.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë G... Sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e R-61123/22 të lëshuar nga ZBD Prishtinë si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 10.01.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr. 06.2/09/2016 i datës 10.01.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se e paditura ka qenë e obliguar të veproj sipas pikëpamjeve juridike dhe vëretjeve të aktgjykimit A.nr.607/18 dt.16.10.2019 të kësaj Gjykate, e paditura ka nxjerrë vendim të ri në rivendosje duke mos bërë vlerësimin e drejt të gjendjës faktike që rezulton nga dokumentacioni përcjellës i mallit doganor, dhe duke aplikuar gabimisht të drejtën material. Edhe pse gjykata i ka bërë me dije të paditurës se është e papranushshme të mos shqyrtohen pretendimet ankimore lidhur me validitetin e dokumentacionit të mallit lëndor si fatura, transaksioni bankar, mirëpo në rastin konkret e paditura i është shmangur këtij rekomandimi të gjykatës për mos anashkalimin e metodave të vlerësimit pa u vërtetuar gjendjen faktike e dokumentacionit të mallit lëndor se është paguar vlera e transaksionit sipas faturës së mallit, transaksionit bankar, konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, andaj e paditura nuk ka provuar të vërtetoj validitetin e asnjë dokumentacioni përcjellës të mallit dhe nuk ka bërë të qartë se cilat dokumente i ka kërkuar nga paditësi për ti shmangur dyshimet e vlerës së transaksionit nga neni 92 të Udhëzimit administrative nr.11/2009. Ndër të tjera ka theksuar se nga admisnistrimi i provave gjykata konstaton se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës faturën përcjellëse të mallit nr.KS 20161104 dt.04.11.2016, urdhërpagesën ndërkombëtare datës 02.11.2016 Pro Credit Bank, e cila pagesë është bërë pikërisht për faturën përcjellëse të mallit, me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, deklaratën e shtetit eksportues, kontrata e shitëblerjes, cmr, të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 që impelenton Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës , andaj gjykata konstaton se janë përmbushur kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore R-61123/22.12.2016 të ZBD Prishtinë. Gjykata konstaton se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura eksport në Kosovë. Ka shtuar se dispozita e nenit 123 par 1 të Udhëzimit

Administrativ nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, është fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siq kërkohet me nenin 91 të këtij Udhëzimi administrative, si dhe në bazë të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109 parasheh: Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, kështu ka theksuar se gjykata nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë . Krejt në fund aktgjykimin e ankimuar e ka mbështet në nenin 81.I par 2 pika 2.2 të Ligjit 04/L-102 dhe neni 46 par 4 të LKA-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81 G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimin të ankimuar nuk është bazuar në faktet e dhëna nga e paditura, por gjendjen faktike e ka nxjerrë komplet nga provat e

paditësit. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, meqë gjykata e shkallës së parë nga arsyetimi i vendimit të kontestuar me të drejtë ka konstatuar se e paditura ka bërë vlerësimin e dokumentacionit përcjellës pa i shqyrtuar në tërësi dhe mos pranimit i vlerës së deklaruar për mallin lëndor është i papranueshëm pasi që paditësi ka prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar në kuptim të vlerës reale të mallit të paraqitur për zhdoganim. Prandaj, për gjykatën është e pa pranueshme që në procedurën administrative të ankesave të mos shqyrtohen në tërësi të gjitha pretendimet ankimore, ngase me nenin 77 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, përcaktohet se “Në vendimin përfundimtar, organi administrativ kompetent vendos për të gjitha çështjet e ngritura gjatë zhvillimit të procedimit”. Andaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes edhe të kësaj gjykate e bënë të pa qëndrueshëm vendimin kontestues.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.985/22, me datë 09.02.2022**

**Kryetare e kolegjit,**

**Franciska Zhitija Ymeri**